



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



NGB „ZËRI“ Sh.p.k.
Nr. i biznesit 70148912
Pronar – “Lindi Media Group” Sh.p.k.-Person juridik
Nr. i biznesit 70602563
Naim EJUPI- Pronar dhe person i autorizuar
OSHP “ ZËRI TV”
Pallati i Shtypit Anex I,
Prishtinë

Ref:1512/1394/LIC/ni

Vendim

për licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “ZËRI TV” – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 6 korrik 2007, ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më datën 21 tetor 2015, kandidati për licencë të KPM-së “ZËRI TV”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së.
4. Me datën 12 nëntor 2015, kandidati për licencë të KPM-së “ZËRI TV”, ka kompletuar aplikacionin, në pajtim me Ligjin për KPM-në dhe aktet nënligjore të KPM-së.

Arsyetim

5. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ZËRI TV”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores CIMC 2007/04.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ZËRI TV” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth strukturës së qartë organizative, të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
8. Sipas nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, kandidati për licencë të KPM-së “ZËRI TV”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
9. Komisioni vlerëson se, kandidati “ZËRI TV” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve programore, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.

Vendim

10. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 8 dhjetor 2015, merr vendim që, kandidatit “ZËRI TV”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore, përmes rrjetit kabllor, në Republikën e Kosovës.

Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë e tij si Ofrues i Shërbimeve Programore vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



10.12.2015

datë